



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

ADMINISTRATA RAJONALE E ZONAVE TË MBROJTURA VLORE

Nr. Prot. 394 Vlorë, 12.02. 2026

Nr. Prot. 92 Vlorë, 16.02 2025

**MARREVESHJE BASHKEPUNIMI**

**NDERMJET:**

**UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE**

**DHE**

**ADMINISTRATA RAJONALE E ZONAVE TE MBROJTURA VLORE**

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, përfaqësuar nga Rektore Prof. Dr. Aurela Saliq, është një institucion publik, që ka statusin juridik, krijuar në pajtim me nenin 57, paragrafi 7 i Kushtetutës së Shqipërisë dhe të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë",

dhe

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Vlorë, përfaqësuar nga Martin Gorici organizohet në nivel vendor në bazë qarku, në varësi të Agjencisë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 102, datë 04.02.2015, dhe vepron në bazë të ligjit Nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" si institucion qëndror dhe ka për detyrë administrimin dhe kontrollin e zonave të mbrojtura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Palë nënshkruajnë këtë Marrëveshje bashkëpunimi me qëllim përcaktimin e formave të bashkëpunimit reciprok (si më poshtë):

**Neni 1**  
**Baza Ligjore**

Kjo Marrëveshje bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 4, gërmasë.

Adresa /Adress: Bulevardi  
Tel. Fax ++355222288

Vlorë-Skele e Fshesë-site: eee.univlora.edu.al  
e-mail: info@univlora.edu.al

  
  




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

**Neni 2**  
**Qëllimi**

1. Të përcaktojë forma bashkëpunimi me interes reciprok, në mënyrë që të sigurohet zbatimi sa më i mirë i politikave për ruajtjen e Zonave të Mbrojtura, duke zbatuar aktivitete menaxhuese për rritjen e ndergjegjësisë dhe edukimit të brezave të ardhshëm.
2. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje dhe vendosja e rregullave për bashkëpunim dypalësh, i shërben lehtësimit të zbatimit të funksioneve të vetë institucioneve nënshkruese dhe të zhvillimit të praktikave të qëndrueshme edukative dhe turistike në zonë.
3. Duke marrë në konsideratë rrjetin e zonave të mbrojtura që shtrihen në qarkun Vlorë, rëndësinë e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, vlerave të rëndësishme natyrore që ato kanë, problematikat mjedisore aktuale si dhe ndikimet negative në këto zona është gjykuar shumë e rëndësishme lidhja e një marrëveshje mes dy institucioneve për ndërmarrjen e veprimtarive të përbashkëta në interes të të dy palëve si në funksion të promovimit, edukimit dhe kërkimit shkencor.
4. Veprimet e koordinuara të të dy institucioneve do të bëjnë të mundur të monitorohen në mënyrë sistematike habitate apo specie të veçanta, të evidentohen problematika apo të parandalohen si dhe të minimizohen problemet mjedisore në këto zona.
5. Kërkimi shkencor i ofruar nga Departamenti i Biologjisë do të interpretojë mbi baza shkencore problemet e sipër përmendura. Studentët e programeve të Departamentit të Biologjisë do të bashkëpunojnë gjithashtu si pjesë e kërkimit gjatë kryerjes së temave të tyre. Administrata e Zonave të Mbrojtura Vlorë do të japë kontributin reciprok në përmbushje me qëllimin dhe misionin e saj, duke vendosur në dispozicion të studentëve gjithë bazën materiale dhe informacionet që ato disponojnë si dhe duke asistuar ekspeditat në terren. Eksperienca e stafit të AdZM-së Vlorë si dhe trajnimet e vazhdueshme me profilin mjedisor do të japin një ndihmesë të frytshme.

**Neni 3**  
**Parime të përgjithshme**

1. Kjo Marrëveshje synon bashkëpunimin mes Palëve në drejtim të mbështetjes ndaj funksioneve menaxhuese, planifikuese, mbrojtëse, zhvilluese dhe kërkimore, si dhe të nxitjes së mundësive të reja për punë kërkimore, menaxhim mjedisor dhe zhvillim të qëndrueshëm.
2. Përcaktimet e kësaj Marrëveshje, nuk çenojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej institucioneve, që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, në bazë të të cilit këto institucione janë krijuar dhe funksionojnë.
3. Kjo Marrëveshje shërben si bazë bashkëpunimi dhe nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore për Palët, si dhe nuk ndryshon ndonjë ligj ose akt nënligjor në fuqi.
4. Kjo Marrëveshje nuk i ndalon Palët të marrin pjesë në aktivitete ose marrëveshje të ngjashme me institucione të tjera. Gjithashtu, kjo Marrëveshje nuk ndikon ndonjë Marrëveshje tjetër që Palët mund të kenë me institucione të tjera.

Adresa /Adress: Bulevardi  
Tel. Fax ++355222288



Vlore-SkeleEeb-site: [eee.univlora.edu.al](http://eee.univlora.edu.al)  
e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Neni 4

Njësia bazë zbatuese dhe përfituesit

Njësia zbatuese e kësaj marrëveshjeje është Departamenti i Biologjisë, i cili vepron në bazë të nenit 25 të Ligjit Nr. 80, datë 22.07. 2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Përfituesit e kësaj marrëveshjeje janë:

1. Staf akademik i Departamentit të Biologjisë, FSHTN, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Administrata e Agjencisë Rajonale e Zonave të Mbrojtura Vlorë
3. Studentët e programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve të ofruar prej Departamentit të Biologjisë.

Neni 5

Format e bashkëpunimit

1. Kjo marrëveshje parashikon vendosjen e një marrëdhënieje afat-gjatë bashkëpunimi mes palëve në fushat e caktuara, me synimin për të arritur:

- a) organizimin e aktivitete të përbashkëta me qëllim sensibilizimin, trajtimin e çështjeve të ndjeshme mjedisore që prekin zonat e mbrojtura;
- b) vënia në dispozicion e burimeve logjistike, bazën materiale si dhe burimet njerëzore të përbashkëta;
- c) Ndërmarrja e nismave mjedisore praktike në kuadër të ditëve mjedisore lokale dhe globale;
- d) Promovimi i vlerave të turizmit mjedisor, agroturizmit si dhe turizmit familjar në zonat e mbrojtura;
- e) Krijimi i mundësive për të mbështetur zhvillimin e kërkimit shkencor në programet e studimit që ofron Departamenti Biologjisë nga ana e studentëve;
- f) Aplikimi si partnerë të përbashkët në thirrje të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- g) Organizimi i takimeve të përbashkëta periodike me qëllim zbatimin e planit të vendosur si dhe rritjen e efikasitetit bashkëpunues;
- h) Organizimi i konferencave kombëtare, ëorkshop-e, shkolla verore, praktikave, internship, seminareve e kurseve për temat e parashikuara nga marrëveshja;
- i) Nxitjen e shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese të laboratoreve didakte dhe kërkimore nga stafet akademike, studentët përkatës dhe punonjësit e AdZM-se në funksion të edukimit, rritjes së kapaciteteve të stafit apo punës kërkimore;

2. Fushat specifike të bashkëpunimit do të jenë ato me interes të ndërsjelltë, të cilat do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen, si më poshtë:

Adresa /Adress: Bulevardi  
Tel. Fax ++355222288

Vlore-SkeleEeb-site: [ee.univlora.edu.al](http://ee.univlora.edu.al)  
e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

- a) Menaxhimi i qëndrueshem i Burimeve Natyrore, Ekosistemeve (detar, bregdetar, tokësor) dhe Zonave të Mbrojtura;
- b) Hartimi i Planeve të Veprimt/Menaxhimit për habitate apo specie të veçanta;
- c) Impakti i turizmit në Zonat e Mbrojtura Vlorë;
- d) Përdorimi i GIS si një mjet i rëndësishëm në vendimarrje për menaxhimin e zonave të mbrojtura;
- e) Programi i Praktikave të Studentëve:
  - Zhvillimi i praktikave mësimore në zona me interes të lartë shkencor duke kontribuar në përditësimin e databasave të florës dhe faunës në zonat e mbrojtura;
  - Zhvillimi i diskutimeve dhe leksioneve të hapura për t'i vënë studentët përballë situatave dhe zgjidhjeve praktike, siç mund të jenë menaxhimi i mbetjeve, planifikim dhe reagimi në rast emergjence, pastrimi dhe kontrolli i mjedisit, etj;
  - Zhvillimi i konferencave të përbashkëta me interes kombëtar mbi punën kërkimore në zonat e mbrojtura në bashkëpunim me dy institucioneve.
  - Asistencë Teknike - inkurajimi, lehtësimi, koordinimi dhe ofrimi i asistencës teknike për stafet përkatëse dhe studentët, duke përfshirë vizitat në objektet përkatëse, konsultimet, takimet, ërkshp-el dhe seminarët, monitorime, aktivitete në terren, analiza cilësore e sasiore, etj.,
  - Trajnime dhe Vizita në Terren koordinimi për të organizuar pjesëmarrjen e studentëve në kurse të ndryshme trajnime dhe vizita në terren;
  - Programi i internshit pranë qëndrave të vizitorëve Radhimë dhe Llogara.

**Neni 6**  
**Roli dhe përgjegjësitë**

- a. AdZM Vlorë kryen hulumtime/studime/analiza të përbashkëta mbi projektet dhe programet zhvillimore me FSHTN në fushat e identifikuara në Nenin 4;
  - b. Identifikon prioritetet kryesore, të cilat lidhen me fushat e bashkëpunimit, si dhe harton një listë të nevojave bazë dhe thelbësore të hulumtimit/studimit/analizës, që mund të përfshihen në programin kërkimor shkencor të FSHTN, në bazë vjetore;
  - c. Ofron mundësi që studentët e FSHTN të kryejnë praktikën mësimore pranë zonave të mbrojtura të qarkut Vlorë si dhe Qendrës së Vizitorëve në Radhimë dhe Parkun Kombëtar Llogara;
  - d. Harton dhe zbaton, në konsultim dhe marrëveshje me FSHTN, programe afatgjata të monitorimit dhe kërkimit shkencor,
  - e. Ofron asistencë duke vendosur në dispozicion të studentëve të gjitha asetet që disponon në funksion të kërkimeve shkencore apo logjistike.
2. Roli dhe Përgjegjësitë e FSHTN:
- a. Ofron, në konsultim dhe marrëveshje me AdZM Vlorë, asistencë teknike në fushat e identifikuara në Nenin 4, duke angazhuar stafin, strukturat dhe pajisjet përkatëse;

Adresa /Adress: Bulevardi  
Tel. Fax ++355222288

Vlore-SkeleËeb-site: eëe.univlora.edu.al  
e-mail: info@univlora.edu.al

*[Signature]*



*[Signature]*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

- b. Harton dhe administron programe afatshkurtra trajnimi të përshtatura sipas programeve akademike dhe nevojave të AdZM Vlorë;
  - c. Realizon bashkë me AdZM Vlorë, projekte dhe programe të përbashkëta kërkimore dhe zhvillimore ;
  - d. Merr pjesë bashkë me AdZM Vlorë në aplikime për mbështetje financiare për projekte dhe programe të përbashkëta.
3. Palët bien dakord për të hartuar një program gjithëpërfshirës kërkimor, i cili do të rrite me tej bashkëpunimin në fushat e kërkimit shkencor dhe konservimit të natyrës në zonë, duke ofruar të dhëna dhe mjete që lidhen me mjedisin dhe që janë të nevojshme për të orientuar vendimarrjen.
4. Palët nënshkruan do të konsultohen sa herë që është e nevojshme, por jo me pak se 1(një) herë në vit, veçanërisht për të vlerësuar veprimtaritë kërkimore, seminare aktivitete mjedisore etj, që ata kanë zhvilluar apo janë duke u realizuar, për të bërë programe pune të përbashkëta 1(një) vjeçare apo 2(dy) vjeçare.

**Neni 7**

**Marrëdhëniet financiare**

- 1. Kjo Marrëveshje nuk përmban detyrime financiar për palët. Marrëveshja nuk mund të përdoret si bazë për ndonjë premtim, përfitim apo transferim fondesh.
- 2. Secila nga Palët do të mbulojë shpenzimet e veta (nëse do të ketë) për aktivitetet e realizuara në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.
- 3. Asnjë dispozitë e Marrëveshjes nuk duhet të interpretohet sikur Palët janë të detyruara të parashikojnë ose të shpenzojnë fonde në kuadër të qëllimeve, objektivave ose përgjegjësisë të përcaktuara në këtë Marrëveshje, ose të parashikojnë ndonjë kërkesë për kompensim për shërbimet e kryera në përputhje me qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

**Neni 8**

**Dispozita përfundimtare**

- 1. Ngarkohen AdZM Vlorë dhe FSHTN me strukturat e tyre përkatëse për zbatimin e detyrave të parashikuara në këtë Marrëveshje;
- 2. Për realizimin e programeve të punës të bëra bashkarisht secila nga palët që nënshkruajnë mund të përcaktojë një bashkëpunëtor përgjegjës;
- 3. Palët duhet t'i përgjigjen me shkrim propozimeve reciproke për modifikime, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së propozimeve.
- 4. Palët mund të ndryshojnë ose të rregullojnë me pëlqim të përbashkët pika të kësaj marrëveshjeje, sipas normave në fuqi.
- 5. Secila prej Palëve mund të terhiqet në mënyrë të njëanshme dhe në çdo kohë nga kjo Marrëveshje duke njoftuar me shkrim Palën tjetër, të paktën 30 ditë përpara.

Adresa /Adress: Bulevardi  
Tel. Fax ++355222288



Vlore-Skele Eeb-site: [ee.univlora.edu.al](http://ee.univlora.edu.al)  
e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)

*[Signature]*

*[Signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Neni 9  
Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e Palëve.  
Marrëveshja hartohet në katër kopje në versionin Shqip dhe secila nga palët mban dy kopje.

PËR

UNIVERSITETIN  
"ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTORI

PROF. DR. AURELA SALIAJ



PËR

ADMINISTRATEN RAJONALE TË  
ZONAVE TË MROJTURA VLORE

DREJTOR

Martin Gorici

